# Tabelë Përputhshmërie

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Celex Nr. 32003R1185**<br>**Rregullore e Këshillit (KE) nr. 1185/2003** e 26 qershorit 2003 mbi heqjen e pendëve të peshkaqenëve në bordin e anijeve<br><br>Fletore Zyrtare e BE-së L 167, 4.7.2003, F. 1–3 | | Legjislacioni Shqiptar i propozuar: Projektligji: “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 64/2012 “Për Peshkimin” të ndryshuar”<br><br>**Përputhshmëri e pjesshme** | | | | |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 |
| Neni | Teksti | Referenca | Neni | Teksti | Përputhshmëria | Shënime |
| Neni 1 | Kjo rregullore do të zbatohet për heqjen e pendëve të peshkaqenëve, mbajtjen në bord, transferimin dhe zbarkimin e peshkaqenëve ose pendëve të peshkaqenëve: | | - | - | I paperafruar | - |
| Neni 1<br>Paragrafi (1) | (1) nga anijet lundruese në ujërat detare nën sovranitetin ose juridiksionin e Shteteve Anëtare; | | - | - | I paperafruar | - |
| Neni 1<br>Paragrafi (2) | (2) nga anijet që mbajnë flamurin ose janë të regjistruara në Shtetet Anëtare në ujëra të tjera detare. | | - | - | I paperafruar | - |
| Neni 2 | Për qëllimet e kësaj rregulloreje, do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme: | | - | - | - I paperafruar | - |
| Neni 2<br>Paragrafi (1) | (1) 'pendë peshkaqeni' do të thotë çdo pendë e peshkaqenëve, duke përfshirë pendët kaudale, por duke përjashtuar pendët pektorale të rajave, të cilat janë pjesë përbërëse e rajave; | | Neni 1<br>Pika 6 | 57/1 “Pendë peshkaqeni” është çdo pendë peshkaqeni, përfshirë këtu edhe pendën kaudale por duke përjashtuar pendët pektorale të rajave. | E plotë | |
| Neni 2(2) | (2) 'peshkaqen' nënkupton çdo peshk të klasës Elasmobranchii; | | Neni 1<br>Pika 6 | 57/2 “Peshkaqen” është çdo peshk që bën pjesë në klasën Elasmobranchii. | E plotë | |
| Neni 3<br>Paragrafi (1) | (1) Ndalohet heqja e pendëve të peshkaqenëve në bordin e anijeve dhe mbajtja në bord,transbordimi ose zbarkimi i tyre. | | Neni 9<br>Pika 2 | “1/1. Ndalohen heqja e pendëve të peshkaqenëve në bordin e anijes, mbajtja në bord, trasbordimi, zbarkimi i qëllimtë i këtyre pendëve.” | E plotë | |
| Neni 3<br>Paragrafi (1a) | (1a) Me përjashtim të paragrafit 1, për të lehtësuar ruajtjen në bord, pendët e peshkaqenit mund të priten pjesërisht dhe të palosen përgjatë karkasës, por nuk duhet të hiqen nga karkasa përpara se të zbarkohen. | | Neni 9<br>Pika 2 | “1/3. Në përjashtim të pikës 1/1, me qëllim lehtësimin e procedurave të ruajtjes dhe magazinimit në bord, lejohet prerja e pjesshme dhe palosja e pendëve të peshkaqenëve.” | E pjesshme | Përshtatur sipas gjuhës shqipe por duke ruajtur të njëtin kuptim |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Neni 3<br>Paragrafi (2) | (2) Ndalohet blerja, ofrimi për shitje ose shitja e pendëve të peshkaqenëve që janë hequr në bord, mbajtur në bord, transborduar ose zbarkuar në kundërshtim me këtë rregullore | | Neni 9<br>Pika 2 | "1/2. Ndalohet shitja, blerja dhe hedhja në treg e pendëve të peshkaqenëve që janë hequr në kundërshtim me pikën 1/1 të këtij neni." | E plotë | |
| Neni 6<br>Paragrafi (1) | (1)Kur anijet që mbajnë flamurin e një shteti anëtar kapin, mbajnë në bord, transportojnë ose zbarkojnë peshkaqenë, Shteti Anëtar i flamurit, në përputhje me Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 1224/2009 të 20 nëntorit 2009 duke krijuar një sistem kontrolli të Komunitetit për garantimin e respektimit të rregullave të politikës së përbashkët të peshkimit dhe Rregulloren Implementuese të Komisionit (BE) nr. 404/2011 të 8 prillit 2011 duke përcaktuar rregullat e detajuara për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) nr. 1224/2009, do t'i dërgojë Komisionit, çdo vit, deri më 1 maj, një raport gjithëpërfshirës mbi zbatimin e kësaj rregulloreje gjatë vitit të kaluar. Raporti përshkruan monitorimin nga shteti anëtar i flamurit të përputhshmërisë me këtë rregullore nga anijet e tij në ujërat e Unionit dhe jo-Uniopnit dhe masat e zbatimit që ka marrë në rastet e mospërputhjes. Në veçanti, shteti anëtar i flamurit duhet të sigurojë të gjithë informacionin e mëposhtëm:<br>-numrin e zbarkimit të peshkaqenëve,<br>-numrin, datën dhe vendin e inspektimeve që janë kryer,<br>-numrin dhe natyrën e rasteve të zbuluara të mospërputhshmërisë, duke përfshirë identifikimin e plotë të anijeve të përfshira dhe dënimin e aplikuar për çdo rast mospërputhjeje dhe<br>- zbarkimet totale sipas llojeve (pesha/numri) dhe sipas portit. | | - | - | - | - |
| Neni 6<br>Paragrafi (2) | (2)Pas paraqitjes nga Shtetet Anëtare të raportit të tyre të dytë vjetor në përputhje me paragrafin 1, Komisioni, deri më 1 janar 2016, i raporton Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi funksionimin e kësaj rregulloreje dhe zhvillimet ndërkombëtare në këtë fushë. | | - | - | I paperafruar | - |
| Neni 7 | Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e 60-të pas botimit të saj në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian. Kjo rregullore është e detyrueshme në tërësinë e saj dhe drejtpërdrejt e zbatueshme në të gjitha Shtetet Anëtare. | | - | - | I paperafruar | - |